



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.695/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sabina Hajdari kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Dragash, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me objekt të çështjes, verifikim i rezultateve, për Zgjedhjet Lokale të 17.10.2021. në seancën e panelit të mbajtur më datë 21.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa A.nr.695/2021 e datës 21.10.2021, e paraqitur nga Sabina Hajdari kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Dragash, për shkak të verifikim të rezultateve në Qendrat e votimit: Fshati Brodsan, Zaplluzhë dhe në Kukë, për Zgjedhjet Lokale 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 21.10.2021, ka pranuar ankesën Anr.695/2021, nga Sabina Hajdari kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Dragash në të cilën thekson se në bazë të dëshmitarit Bajram Aliu nga Brodsami, dhe dëshmitarëve të tjerë në Qendrat e votimit: Fshati Brodsan, Zaplluzhë dhe në Kukë, i mungojnë mbi 100 vota.

Si dëshmi ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se: Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlersimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë në vendvotimet me nr. Qendrat e Votimit: Fshati Brodsan, Zaplluzhë dhe në Kukë, Komunën e Dragashit, për faktin se shkeljet që ndërlihen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së Sabina Hajdari nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 695/2021 më datën 21.10.2021

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

**Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi**

